




Në  
këtë  
periodik  
do të lexoni:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare  
do të mirëpresë në Tiranë Konferencën Vjetore  
Globale të Organizatës Ndërkombëtare të  
Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS 2025



## VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,  
Janar-Gusht 2025

5

## ZHVILLIME TË TJERA

6-8

## BOTIME PROFESIONALE

9-10

## INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

11-14

## AMF do të mirëpresë në Tiranë Konferencën Vjetore Globale të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve 2025



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të mirëpresë në Tiranë Konferencën Vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), ngjarjen më prestigjioze në nivel global në fushën e sigurimeve.

Konferenca do të mbahet më 13 nëntor, në ambientet e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit. Pritet pjesëmarrja e rreth 500 përfaqësuesve të nivelit të lartë nga autoritetet rregullatore të sigurimeve, nga industria ndërkombëtare e sigurimeve, si dhe nga institucione financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, OECD, Bashkimi Evropian dhe EIOPA (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve).

Aktiviteti i plotë do të zhvillohet përgjatë javës 10–14 nëntor 2025. Gjatë tre ditëve të para të javës do të zhvillohen mbledhjet e komiteteve teknike të IAIS, me pjesëmarrjen e rreth 230 drejtuesve të autoriteteve rregullatore nga mbi 150 vende. Në kuadër të aktivitetit janë planifikuar edhe takime bilaterale ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe takime të veçanta ndërmjet drejtuesve të kompanive ndërkombëtare të sigurimeve, me qëllim krijimin e hapësirave për bashkëpunim dhe dialog strategjik në nivel drejtues të industrisë.

Një nga aktivitetet kryesore të javës do të jetë Forumi i EIOPA-s, me temë: *“Advancing Insurance Reforms on the Path to European Integration”*, i cili do të fokusohet në sfidat dhe mundësitë që sjell procesi i integritimit evropian për vendet candidate, në përputhje me objektivat strategjike të Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Vijon ...

Informacioni mbi  
Konferencën Vjetore të  
Organizatës  
Ndërkombëtare të  
Mbikëqyrësve të  
Sigurimeve, IAIS  
gjendet në linkun  
<https://iais2025.com/>

**AMF do të mirëpresë në Tiranë  
Konferencën Vjetore Globale  
të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve  
2025**



... vijon

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, znj. Mimoza Kaçi, e cilëson këtë ngjarje jo vetëm një moment historik, por edhe një mundësi për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për prezantimin e Shqipërisë si partner në fushën e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve. Ky organizim vjen në një moment të rëndësishëm për tregun shqiptar të sigurimeve, duke mbështetur proceset reformuese dhe integruese, me synim forcimin e institucioneve dhe të sektorit financiar, në përputhje me standardet evropiane.

Pas Tokios në vitin 2023 dhe Cape Town-it në vitin 2024, përzgjedhja e Tiranës si qytet mikpritës për edicionin e vitit 2025 është një vlerësim i rëndësishëm për vendin dhe për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare si institucioni rregullator dhe mbikëqyrës.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – gusht 2025


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – gusht 2025 kapën vlerën 17,906 milionë lekë, ose 9.53% më shumë se në janar – gusht 2024. Gjatë periudhës janar – gusht 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,116,204 me një rritje prej 6.12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.57% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.40% dhe risigurimi me 0.026%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.16% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.84% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – gusht 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve arritën në rreth 5,468 milionë lekë, ose 2.27% më pak se në janar – gusht 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – gusht 2025 kapën vlerën 4,195 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 2.59% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar – gusht 2025 arritën rreth 11,074 milionë lekë, ose 12.76% më shumë se në janar – gusht 2024.



# ZHVILLIME TË TJERA

## Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, znj. Mimoza Kaçi, pjesë e panelit ndërkombëtar në Konferencën e EIOPA-s në Frankfurt



*Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi ndau përvojën e Shqipërisë si një treg në zhvillim që përballet me sfida, por edhe me mundësi të mëdha dixhitalizimi, ku përdorimi i teknologjive të reja nxit rritjen e aksesit të publikut në produkte sigurimi.*

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi Mbikëqyrjen Globale të Sigurimeve 2025, organizuar nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Qendra Ndërkombëtare për Rregullimin në Sigurime (ICIR).

Në panelin me temë “Rezistenca ndaj rreziqeve në kohën e transformimit digjital”, znj. Kaçi ndau përvojën e Shqipërisë si një treg në zhvillim që përballet me sfida, por edhe me mundësi të mëdha dixhitalizimi, ku përdorimi i teknologjive të reja nxit rritjen e aksesit të publikut në produkte sigurimi. Ajo nënvizoi rëndësinë e investimeve në infrastrukturë teknologjike, forcimin e kapaciteteve, rritjen e besimit të konsumatorëve, si dhe konsolidimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës, në mbështetje të inovacionit dhe për zhvillime të qëndrueshme në tregun shqiptar të sigurimeve.

Duke iu referuar rolit rregullator, znj. Kaçi theksoi se Autoriteti po punon për harmonizimin e legjislacionit vendas me Acquis të BE-së, përfshirë kalimin drejt regjimit të Solvency II, si dhe për zhvillimin e planeve për qëndrueshmërinë operacionale në përputhje me rregulloren europiane “Digital Operational Resilience Act” (DORA).

Vijon ...

**Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së,  
znj. Mimoza Kaçi, pjesë e panelit ndërkombëtar në  
Konferencën e EIOPA-s në Frankfurt**



... vijon

Ky panel, me pjesëmarrje ndërkombëtare të nivelit të lartë nga institucionet rregullatore dhe nga industria e sigurimeve, u moderua nga z. Clement Cheung, Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Sigurimeve të Hong Kongut.

Përfaqësimi në këtë forum prestigjioz ndërkombëtar konfirmon angazhimin dhe rolin proaktiv të Autoritetit në arenën ndërkombëtare.

## AMF organizon tryezë diskutimi për zhvillimin e tregut të derivateve në Shqipëri



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi një tryezë diskutimi për përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar me rregulloren e Bashkimit Evropian për infrastrukturën e tregut (EMIR), si dhe hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e tregut të derivativëve në Shqipëri.

---

*Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, theksoi se tregu i instrumenteve derivativë, i cili sot mungon në Shqipëri, përfaqëson një segment kyç në ndërtimin e një tregu kapitalesh më të zhvilluar dhe konkurrues.*


---

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të Autoritetit, Bankës së Shqipërisë, aktorë të tregut, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të fushës, të cilët ndanë qëndrime dhe rekomandime mbi nevojat dhe perspektivat për zhvillimin e këtij segmenti të tregut.

Në fjalën e mbajtur në hapje të aktivitetit, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, znj. Mimoza Kaçi, në cilësinë e Kryenegociatores të Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, vlerësoi rëndësinë e këtij projekti për forcimin dhe modernizimin e tregjeve financiare në vend. “Tregu i instrumenteve derivativë, i cili sot mungon në Shqipëri, përfaqëson një segment kyç në ndërtimin e një tregu kapitalesh më të zhvilluar dhe konkurrues. Roli i tij është thelbësor për menaxhimin e rrezikut, mbrojtjen ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe forcimin e stabilitetit financiar në tërësi,” – u shpreh znj. Kaçi.

Aktiviteti përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në vijim të përmbushjes së angazhimeve të Autoritetit në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian krijimin e një tregu financiar të zhvilluar, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e BE-së.

## IAIS ka rilançar Instrumentet e Vetëvlerësimit të ICP-ve, SAT



The screenshot shows the IAS website interface. At the top, there is a navigation bar with the IAS logo and menu items: CONTACT, USER PORTAL, and social media icons. Below the navigation bar is a large banner image of a city at night. Underneath the banner, there are navigation tabs: About the IAS, Activities and Topics, Publications, Consultations, and News and Events. The main content area is titled "ICP Self-Assessment Tool". It contains several paragraphs of text explaining the tool's purpose and how to use it. There is also a sidebar on the right with the heading "About the ICPs" and a search bar.

IAIS ka rilançar Instrumentet e Vetëvlerësimit të ICP-ve, SAT, të cilat më parë janë përmbledhur nga Iniciativa për Përfshirje në Sigurime (A2ii). Këto Instrumente të Vetëvlerësimit kanë cilësi të përmirësuar të përdorimit dhe të sigurisë, si edhe do të ofrojnë një burim të vlefshëm për të ndihmuar mbikëqyrësit të vlerësojnë respektimin e Parimeve Themelore të Sigurimeve (ICP).

Informacioni i plotë gjendet në:

<https://www.ias.org/activities/topics/implementation-assessment/self-assessment-tool/>

SAT u lejon mbikëqyrësve të sigurimeve të vlerësojnë pajtueshmërinë me ICP-të, të marrin reagime të menjëhershme, të identifikojnë fushat për përmirësim dhe të ndjekin progresin drejt përbushjes së standardeve globale.

ICP-të ofrojnë një kornizë të pranuar globalisht për mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve, të zbatueshme për të gjitha juridiksionet, pavarësisht nga pjekuria e tregjeve të tyre të sigurimeve ose llojet e produkteve dhe shërbimeve të sigurimeve që rregullojnë. Përmes SAT, juridiksionet mund të kryejnë vetëvlerësime duke përdorur pyetësorë të strukturuar dhe kritere vlerësimi, në përputhje me metodologjinë e aplikuar në Procesin e Rishikimit nga Kolegjet (PRP).

## **IOSCO njofton fillimin e edicionit të 9-të të Javës Botërore të Investitorëve, 6-12 Tetor 2025**



Java Botërore e Investitorëve (WIW) e IOSCO-s është një fushatë globale njëjavore për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve dhe për të nxjerrë në pah iniciativat e ndryshme të rregullatorëve të letrave me vlerë në këto dy fusha kritike.

Duke filluar më 6 Tetor 2025, dhe me mbështetjen e Presidencës së G20, WIW 2025 bashkon organizata nga mbi 100 juridiksione për të rritur ndërgjegjësimin rreth çështjeve të ditës, që ndikojnë te investitorët në të gjithë botën.

Temat kryesore të këtij viti përfshijnë Financën Dixhitale dhe Asetet Kripto, ndikimin e Teknologjive të reja dhe IA-së, parandalimin e Mashtrimeve dhe Bazat e Investimit. Ato përputhen me Udhërrëfyesin e IOSCO-s për Sigurinë Online të Investitorëve me Pakicë.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Jean-Paul Servais, i cili është edhe Kryetar i Autoritetit të Shërbimeve dhe Tregjeve Financiare të Belgjikës theksoi se “Në tregjet e sotme, teknologjia po transformon me ritëm të shpejtë mënyrën se si njerëzit investojnë. Për studentët dhe investitorët e rinj, platformat dixhitale tani janë shpesh porta hyrëse në botën e investimeve. Investitorët e zgjuar u përmbahen bazave, duke bërë kërkime të kujdesshme, duke qëndruar dhe duke u përgatitur për ngjarje të papritura.”

Z. Camille Beaudoin, Drejtor i Ekspertizës dhe Partneriteteve për Edukimin Financiar, në AMF Québec dhe Kryetar i Komitetit të IOSCO-s që drejton fushatën e këtij viti, shtoi se “Mashtrimet e lidhura me investimet vlerësohet se kanë bërë që njerëzit të humbasin dhjetëra miliarda dollarë në nivel global. Fushata kundër mashtrimit në investime gjatë Javës Botërore të Investimeve 2025, e mundësuar edhe nga mbështetja e shumë organizatave të mirënjohura në të gjithë globin, synon të informojë investitorët rreth shenjave paralajmëruese të këtyre mashtrimeve dhe t'i ndihmojë ata të fuqizohen me informacion për të mbrojtur veten.”

Ashtu si në vitet e kaluara, Java Botërore e Investitorëve 2025 do të mbështetet nga mjaft organizata partnere.

Informacioni i plotë  
gjendet në:

<https://www.iais.org/activities-topics/implementation-assessment/self-assessment-tool/>

## BULLGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave zyrtare tremujore të publikuara në faqen e internetit të Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare, tregu bullgar i sigurimeve, për tremujorin e parë të vitit 2025, raportoi një vlerë prej 1.37 miliardë levash ose rreth 698.65 milionë euro. Kjo vlerë shënon një rritje prej 21.58% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vëllimi i primeve të shkruara bruto i siguruesve të Jetës u rrit me 10.8% duke arritur në 210 milionë leva, ndërsa për sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 23.67%, duke arritur në 1.15 miliardë leva.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit me 21.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 574.23 milionë levash, ose rreth 293.6 milionë euro, për shkak të rritjes prej pothuajse 29% në segmentin e Jo-Jetës.

## ÇEKI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Bankës Kombëtare Çeke, BKÇ, siguruesit çekë e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2025 një vëllim të primeve të shkruara bruto rreth 5.05 miliardë euro, ose rreth 8.1% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara bruto u rritën me 7.07%, duke arritur në 2.45 miliardë euro.

Sektori i sigurimeve të Jetës pati një dinamikë pozitive, megjithëse me një ritëm pak më të ngadaltë se sigurimet e Jo-Jetës. Vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 7.67% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 1.25 miliardë euro. Disa nga klasat e sigurimit të Jetës regjistruan norma pozitive rritjeje, me dy shifra. Dëmet e paguara u rritën në përgjithësi rreth 1%.

Në sigurimet e Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara u rrit me 8.25%, duke arritur në 3.8 miliardë euro, një total që përfshin edhe risigurimin e pranuar. Pjesa më e madhe e kësaj shume u siguroa nga linjat e sigurimit motorik, për të cilat primet arritën në vlerën e 1.67 miliardë euro. Sigurimi i pronës është segmenti i dytë më i madh Jo-Jetës, me vlerë 959.6 milionë euro të primeve, një rritje prej 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me rreth 10%, duke arritur në 1.73 miliardë euro. Edhe dëmet e paguara për sigurimin e pronës u rritën me 38.4%, duke arritur në 421 milionë euro.

Shifrat e BKÇ-së përfshijnë informacion mbi të gjithë siguruesit çekë, degët e siguruesve nga shtetet e tjera anëtare të BE-së ose EEA-së dhe degët e siguruesve nga vende të tjera në Republikën Çeke. Gjithashtu përfshihen të dhëna mbi degët e këtyre siguruesve që operojnë jashtë vendit.

## HUNGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave më të fundit mbikëqyrëse të Bankës Kombëtare të Hungarisë, sektori i sigurimeve në vend tregoi rritje dhe stabilitet të fortë në gjysmën e parë të vitit 2025. Vëllimi i primeve të shkruara bruto, në fund të 6-mujorit të parë 2025 arriti në 1,047.7 miliardë HUF ose rreth 2.62 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 20.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 38.3%, ndërsa ato të sigurimit të Jo-Jetës patën një rritje prej 9.9%.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në gjysmën e parë të vitit 2025, vëllimi i primeve të shkruara bruto për 14 kompanitë e sigurimeve që vepronë në tregun kroat arriti vlerën e rreth 1 miliardë euro, ose 8.3% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për të njëjtën periudhë, vlera e dëmeve të paguara pësoi një rënie me 9.25%, në krahasim me 6-mujorin e parë të vitit të kaluar, duke arritur në 594 milionë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës ishte 170.9 milionë euro apo rreth 3.2% më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa 861.3 milionë euro ishte vlera e primeve të sigurimit të Jo-Jetës, që shënoi një rritje me 10.9% më shumë krahasuar me 6-mujorin e 2024.

Në strukturën e primeve të sigurimit të Jo-Jetës, sigurimi i përgjegjësishë për mjetet motorike zë peshën më të madhe, me rreth 35.5%, i ndjekur nga sigurimi i automjeteve rrugore me 19.6%, sigurimi nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore 9.1% dhe sigurimi shëndetësor 8.8%.

Në dëmet e paguara në gjysmën e parë të vitit 2025 sigurimi i Jetës përbënte 179.7 milionë euro ose 30.25% dhe sigurimi i Jo-Jetës përbënte 414.4 milionë euro ose 69.75% të totalit. Në dëmet e paguara në sigurimin e Jo-Jetës, shumat më të mëdha lidhen me sigurimin e përgjegjësishë ndaj automjeteve motorike me 41.0%, sigurimin e automjeteve rrugore me 21.6%, sigurimin shëndetësor me 12.5% dhe sigurimin nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore me 8.8% të totalit të dëmeve të paguara.

## **POLONI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, KNF, në gjysmën e parë të vitit 2025, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit polakë arriti në 44.39 miliardë PLN ose rreth 10.47 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 3.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jetës shënoi rritje me 2.6% dhe sigurimi i Jo-Jetës rritje me 4%. Ndërkohë dëmet e paguara bruto pësuan rritje me rreth 10%, duke arritur në 26.34 miliardë PLN ose rreth 6.2 miliardë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit motorik spikati në gjashtëmujorin e parë 2025 duke u rikthyer me fitim, me një tepricë prej 52.96 milionë PLN, kjo pas humbjes së madhe të vitit të kaluar. Kjo rritje u ndikua nga primet më të larta dhe vlerësimi i përmirësuar i rrezikut. Sigurimi Kasko gjithashtu performoi mjaft mirë, duke arritur një fitim të kombinuar prej mbi 530 milionë PLN.

Primet e sigurimit të pronës u rritën në 6.53 miliardë PLN, ose rreth 1.54 miliardë euro. Ndërkohë që dëmet e paguara u rritën me 25% duke arritur në 3 miliardë PLN, pjesërisht për shkak të pagesave bujqësore.

## **SERBI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave statistikore të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, NBS, siguruesit në vend e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2025 me një total të primeve të shkruara bruto prej 97.6 miliardë dinarësh ose rreth 833 milionë euro. Kjo shifër është pothuajse 10% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara u rritën me një ritëm të ngjashëm, duke arritur në 42.17 miliardë dinarë, rreth 360 milionë euro. Struktura e portofolit të tregut mbeti kryesisht e pandryshuar, me sigurimin e Jetës që përbënte 16.3% të totalit të primeve, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës kishte pjesën më të madhe duke dominuar tregun. Linjat e sigurimit motorik gjeneruan pothuajse gjysmën e vëllimit të primeve të Jo-Jetës, ndërsa sigurimi i pronës kontribuoi afërsisht 20%.

Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Shoqatës së Siguruesve Serbë (UOS), mbulimi i sigurimit për tokën e punëshme në Serbi është rritur në mënyrë modeste vitet e fundit, nga rreth 10% para pandemisë në rreth 15% në gjysmën e parë 2025. Megjithatë, shumica e fermerëve ende mbështeten vetëm në policat bazë, pavarësisht rreziqeve në rritje nga ngricat e pranverës, stuhitë dhe përmbytjet. Shoqata e Siguruesve UOS theksoi ndërgjegjësimin e kufizuar midis fermerëve si një pengesë të madhe, duke theksuar nevojën për promovimin institucional të sigurimeve si një pjesë standarde e prodhimit bujqësor. Gjithashtu një subvencion i njëtrajtshëm shtetëror për primet - që aktualisht është nga 40% - 70% në varësi të rajonit - do të ishte thelbësor për të stimuluar një përfshirje më të gjerë, thekson shoqata UOS.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu slloven i sigurimeve u rikthye në tendenca pozitive e rritje, pas rënies dramatike në vitin 2024, për shkak të ndryshimeve në sistemin e sigurimeve shëndetësore. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për 6-mujorin e parë 2025 u rrit me 11% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 1.6 miliardë euro.

Vlen të kujtohet se arsyeja kryesore për ndryshimin negativ në vitin 2024 ishte rënia prej gati 90% në biznesin e sigurimeve shëndetësore si rezultat i vendimit qeveritar për të shfuqizuar, duke filluar nga 1 janari 2024, sigurimin plotësues shëndetësor vullnetar dhe për ta zëvendësuar atë me një kontribut të detyrueshëm shëndetësor të menaxhuar nga instituti publik i sigurimeve shëndetësore të Sllovenisë. Të gjitha policat e lëshuara nga kompanitë e sigurimeve që ofrojnë sigurim plotësues shëndetësor kanë skaduar automatikisht më 31 dhjetor 2024.

Në fund të gjysmës së parë të vitit 2025, sigurimi i Jetës përbënte 31% të portofolit të tregut, me prime që kapnin vlerën e rreth 500 milionë euro. Nga linjat e biznesit të sigurimeve Jo-Jetës, sigurimet motorike përbënin pjesën më të madhe, me më shumë se 50% të vëllimit total të primeve të Jo-Jetës. Ndërsa sigurimi Kasko përbënte 28% të portofolit të sigurimeve të Jo-Jetës. Vëllim i primeve për këtë linjë të biznesit arriti në 305.5 milionë euro, me pothuajse 7% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimet MTPL patën një rritje prej 13.4% të primeve, duke arritur në 262 milionë euro.

Sigurimi i pronës përbën rreth 25% të sigurimit të Jo-Jetës, i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis sigurimit nga zjarri dhe sigurimit të pronës. Vëllimi i primeve për sigurimin e pronës arriti në 257.26 milionë euro, me 10.3% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas komenteve të mëparshme të autoritetit mbikëqyrës, rritja e regjistruar nga klasat e sigurimeve motorike dhe të pronës i detyrohet si rritjes së numrit të policave ashtu edhe çmimeve më të larta të sigurimeve.



Për informacion  
të mëtejshëm  
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)